



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1701/4 prot

Datë 27.07.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 681/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.07.2023 me

**Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS) SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-73392-06-22-2023, me objekt “LCD Wall për sallën operative” me fond limit 9,994,575.00 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.07.2023 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.

**Autoriteti Kontraktor:** ILLYRIAN GUARD SH.A  
Adesa: Ibrahim Rugova, Tiranë 1016

**Ankimues:** Operatori ekonomik “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS) SHPK  
Adresa: Rruga e Kavajës, Kompleksi “Square 21”, sh.2, k.9 me numër pasurie 1/710+2-30

**Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe

*funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.06.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-73392-06-22-2023, me objekt “LCD Ëall për sallën operative” me fond limit 9,994,575.00 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.07.2023 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.

II.2. Në datën 10.07.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- Fredi Electronic SHPK	7,830,000	lekë	skualifikuar
- BNT Electronics SHPK	9,600,000	lekë	skualifikuar
- I.S.S (Integrated Smart Solutions) SHPK	9,744,300	lekë	skualifikuar
- E-Tech SHPK	9,894,000	lekë	skualifikuar

II.3 Operatori ekonomik I.S.S “(INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

- *ISS skualifikohet sepse 1. Çertifikatat e tajnimeve për punonjësit të lëshuara nga Hikvision, nuk janë të sakta, pasi nuk kanë të përcaktuara datën e kryerjes së trajnimit. 2. Garancia e kërkuar nga AK për pajisjet e kërkuara është 3 vjeçare, ndërsa OE ISS nuk ka përcaktuar në skedë teknike garancinë që merr përsipër të mbulojë për pajisjet e ofertuara.*

II.4. Në datën 12.07.2023, autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim-Anulimit në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.5. Në datën 17.07.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3272, si dhe nr. protokoli 1701/2023 datë 17.07.2023 e operatorit ekonomik I.S.S “(INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 1701/2 prot., datë 17.07.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues I.S.S “(INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK.

II.7. Njëpërmjet shkresës me nr. 930/31 prot., datë 25.07.2023, protokolluar me tonën me nr. 1701/3 prot., datë 27.07.2023 me lëndë “Përcillet vendimi për ankesën online të operatorit ekonomik I.S.S me nr. A/2023/3272 prot. 1701/2 datë 17.07.2023 protokolluar pranë AK me nr. 930/28 datë 18.07.2023 për procedurën me objekt “LCD Wall për sallën operative” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi nr. 930/30 prot, datë 25.07.2023, mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues I.S.S “(INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK dhe me shkresën nr. 930/31 prot., datë 25.07.2023, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës, konkretisht citoj:

“[...]

KSHA gjykon se vlerësimi i KVO nuk qëndron për arsytet e mëposhtme:

- i. AK nuk ka kërkuar dokumenta mbështetëse për kriterin e veçantë nr. 2.3.6 sikurse edhe për kriteret e tjera të veçanta pjesë e seksionit “Për kapacitetin teknik”. Konkretisht në këtë seksion përfshihen edhe kërkesat e AK ku shprehet se- të paktën një nga punonjësit e mësipërm duhet të zotërojë një certifikatë kualifikimi nga kompania prodhuese e LCD Wall-it kontroller “Decoder” dhe OE ka plotësuar kriterin pasi ka paraqitur dy certifikata trajnimi dhe jo vetëm një sa ka kërkuar AK. Pretendimi i KVO se certifikatat e trajnimit nuk janë të sakta për shkak të datës së kryerjes së trajnimit nuk qëndrojnë pasi certifikatat kanë datë vlefshmërie, vulë, firmë dhe janë të njehsuara me origjinalin nga Notere S.A.T [...] KSHA vlerëson se vendimi i KVO-së nuk është i saktë.
- ii. Formulari i vetëdeklarimit përdoret për kriteret të përcaktuara në LPP dhe VKM, duke bërë pjesën e kriteret e përgjithshme. AK ka kërkuar certifikata për 1 (një) punonjës të paktën 1(një) nga punonjësit e mësipërm duhet të zotërojë një certifikatë kualifikimi nga kompania prodhuese e LCD Wall-it kontroller “Decoder”, certifikim të cilat janë të domosdoshme për të krijuar bindjen tek AK që ofertuesit do të mund të zbatojnë kontratën në fjalë. Përveç faktit se OE ka paraqitur dokumentat e kërkuara nga AK ky dokument është vërtetim që mund të pranohen me formular përmbledhës vetëdeklarimi. Neni 82, i LPP ka përcaktuar qartë rastet e përfshira në këtë formular.
- iii. Lidhur me pretendimin e KVO se:

Oferta e “I.S.S (Integrated Smart Solution)” SHPK është skualifikuar për mospërmbushjen e specifikimeve teknike. Nga verifikimi i katalogut të dërguar nga OE u kontrollua nga KVO e cila e vlerëson si më poshtë:

Garancia e kërkuar nga AK për pajisjet e kërkuara është 3 vjeçare, nërsa OE ISS nuk ka përcaktuar në skedë teknike garancinë që merr përsipër të mbulojë për pajisjet e ofertuara.

KSHA pas kqyrjes së DT vlerëson se në asnjë rresht nuk ka kërkuar që O.E të përcaktojë në skedë teknike garancinë që merr përsipër të mbulojë për pajisjet e ofertuara.

Konkretisht në DST kërkohej 2 deklarata:

2.3.7. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër realizimin e kontratës sipas afateve dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në specifikime teknike.

2.3.8. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër të gjitha kërkesat funksionale dhe specifikimet teknike të kërkuara nga AK.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit KSHA vlerëson se operatori ekonomik duhet të plotësojë garancinë për mallin e dorëzuar në momentin që bën dorëzimin e tij pranë AK.

Operatori ekonomik në vetëdeklarim në përmbushje të kërkesës së mësipërme, pika e dytë e së cilës është garancia, ka ngarkuar në sistem Deklaratën ku merr përsipër të gjitha kërkesat funksionale dhe specifikimet teknike sic kërkohej nga AK në kriterin 2.3.8 merr përsipër të realizojë objektin në përputhje me listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

[...] Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave,

Vendosi:

1. Pranimin e ankesës së “I.S.S (Integrated Smart Solution)” SH.P.K

2. *Kualifikimin e OE "I.S.S (Integrated Smart Solution)" SH.P.K.*
3. *Ky vendim i bëhet me dije Komisionit të Vlerësimit të Ofertave "I.S.S (Integrated Smart Solution) SHPK dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*
4. *Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues I.S.S "(INTEGRATED SMART SOLUTIONS)" SHPK dhe me shkresën nr. 930/31 prot., datë 25.07.2023, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës, konkretisht citoj:

*"[...]"*

*KSHA gjykon se vlerësimi i Kvo nuk qëndron për arsyet e mëposhtme:*

- i. *AK nuk ka kërkuar dokumenta mbështetëse për kriterin e veçantë nr. 2.3.6 sikurse edhe për kriteret e tjera të veçanta pjesë e seksionit "Për kapacitetin teknik". Konkretisht në këtë seksion përfshihen edhe kërkesat e ak ku shprehet se- të paktën një nga punonjësit e mësipërm duhet të zotërojë një certifikatë kualifikimi nga kompania prodhuese e LCD Wall-it controller "Decoder" dhe OE ka plotësuar kriterin pasi ka paraqitur dy certifikata trajnimi dhe jo vetëm një sa ka kërkuar AK. Pretendimi i KVO se certifikatat e trajnimit nuk janë të sakta për shkak të datës së kryerjes së trajnimit nuk qëndrojnë pasi certifikatat kanë datë vlefshmërie, vulë, firmë dhe janë të njehsuara me origjinalin nga Notere S.A.T [...].KSHA vlerëson se vendimi i KVO-së nuk është i saktë.*
- ii. *Formulari i vetëdeklarimit përdoret për kriteret të përcaktuara në LPP dhe VKm, duke bërë pjesën e kriteret e përgjithshme. AK ka kërkuar certifikata për 1 (një) punonjës të paktën 1(një) nga punonjësit e mësipërmduhet të zotërojë një certifikatë kualifikimi nga kompania prodhuese e LCD ëall-it controller "Decoder", certifikim të cilat janë të domosdoshme për të krijuar bindjen tek AK që ofertuesit do të mund të zbatojnë kontratën në fjalë. Përveçftit se OE ka paraqitur dokumentat e kërkuara nga AK ky dokument është vërtetim që mund të pranohen me formular përmbledhës vetëdeklarimi. Neni 82, i LPP ka përcaktuar qartë rastet e përfshira në këtë formular.*
- iii. *Lidhur me pretendimin e KVO se:*

*Oferta e "I.S.S (Integrated Smart Solution)" SHPK është skualifikuar për mospërmbushjen e specifikimeve teknike-Nga verifikimi i katalogut të dërguar nga OE u kontrollua nga KVO e cila e vlerëson si më poshtë:*

*Garancia e kërkuar nga AK për pajisjet e kërkuara është 3 vjeçare, ndërsa OE ISS nuk ka përcaktuar në skedë teknike garancinë që merr përsipër të mbulojë për pajisjet e ofertuara.*

*KSHA pas kqyrjes së DT vlerëson se në asnjë rresht nuk ka kërkuar që O.E të përcaktojë në skedë teknike garancinë që merr përsipër të mbulojë për pajisjet e ofertuara.*

*Konkretisht në DST kërkohen 2 deklarata:*

*2.3.7. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër realizimin e kontratës sipas afateve dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në specifikime teknike.*

*2.3.8. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër të gjitha kërkesat funksionale dhe specifikimet teknike të kërkuara nga AK.*

*Pas shqyrtimit të dokumentacionit KSHA vlerëson se operatori ekonomik duhet të plotësojë garancinë për mallin e dorëzuar në momentin që bën dorëzimin e tij pranë AK.*

*Operatori ekonomik në vetëdeklarim në përmbushje të kërkesës së mësipërme, pika e dytë e së cilës është garancia, ka ngarkuar në sistem Deklaratën ku merr përsipër të gjitha kërkesat funksionale dhe specifikimet teknike sic kërkohet nga AK në kriterin 2.3.8 merr përsipër të realizojë objektin në përputhje me listën mallrave dhe grafikun e lëvrimin të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.*

*[...]Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave,*

*Vendosi:*

- 5. Pranimin e ankesës së “I.S.S (Integrated Smart Solution)” SH.P.K*
- 6. Kualifikimin e OE “I.S.S (Integrated Smart Solution)” SH.P.K.*
- 7. Ky vendim i bëhet me dije Komisionit të Vlerësimit të Ofertave “I.S.S (Integrated Smart Solution) SHPK dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

*III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

*III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga*

operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente në cilësinë e subjektit të interesuar në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në autoritetin kontraktor (referuar kjo informacionit të autoritetit kontraktor të dërguar në KPP) dhe as në Komisionin e Prokurimit Publik.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konkretisht aktit të trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimes, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik I.S.S “(INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK, kështu që rrjedhimisht, për sa kohë nuk janë paraqitur argumente nga subjektet e interesuara, Komisioni në mbështetje të nenit 115 pika 3 gërma a), mbyll çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik I.S.S “(INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-73392-06-22-2023, me objekt “LCD Wall për sallën operative” me fond limit 9,994,575.00 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.07.2023 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
  3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK.
  4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

